



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 98/13
Prishtinë, më 07.03.2013, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, Arbëreshë Kosumi (Praktikante)

Gjithashtu ishin të pranishëm: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidentes.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtuara të Komisionit, dt. 26.02.2013 dhe 27.02.2013;**
3. **Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Vlerësues për kandidatët për Guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë përgjithshme të produkteve, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Shqyrtimi i amendamentit plotësues të Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin nr.04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit;**
6. **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media për kompensimin e takimeve ditore;**
7. **Shqyrtimi i kërkesës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për shtesa në paga dhe kompensime për zyrtarët e ARH-së;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetajra konstatoi se rendi i dites miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit , dt. 26.02.2013 dhe 27.02.2013

Kryetarja konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Vlerësues për kandidatët për Guvernator të Bankës Qëndrore të Kosovës

Kryetarja njoftoi mbi procedurat e zhvilluara nga Paneli Vlerësues i BQK-së, në shpalljen e konkursit, publikimit të tij në gazetat shqipe dhe relevante serbe, intervistimin e kandidatëve që kanë plotësuar kushtet. Bazuar në performacën dhe kualitetin gjatë intervistës, Paneli i ka propozuar dy kandidatë: z. Bedri Hamza dhe Gani Gërguri që i kanë plotësuar kushtet në tërësi sipas Ligjit për BQK-në. Komisioni duhet të vlerësojë se a janë respektuar procedurat dhe a i përmbushin kushtet ligjore kandidatët dhe të rekomandoj për Kuvend.

Sali Asllanaj mendoj se të dy kandidatët i plotësojnë kushtet dhe procedurat janë të gjitha në rregull. Realisht, z.Bedri Hamza, do të ishte më mirë të qëndronte ministër, sepse e ka kryer punën mirë dhe kemi pasur një bashkëpunim në nivel. Natyrisht, se do të bëhet votimi në Parlament, dhe Parlamenti vendos, por gjithësesi , respektin që kemi për ministrin ,në asnjë mënyë nuk e zbehë kandidimi,që ka bërë për Guvernator.

Latif Gashi konstatoi se Bedri Hamza ka qenë një ndër ministrat më të suksesshëm nga të gjithë ministrat pas luftës, poashtu është një ndër financierët më të mirë. Megjithatë, e respektoj vendimin e tij për ta lenë anash politikën, për t'u marrë me çështje financiare dhe vlerësoj punën e panelit.Ne, si komision, do të duhej të rekomandojmë të dy kandidatët për seancë.

Hykmete Bajrami nuk ka vërejtje për sa i përket procedurave dhe kualifikimeve të tyre, vetëm se , si duket, ky është një hap tjetër drejtë politizimit të institucioneve të pavarura. Banka Qendrore e Kosovës ,në bazë të Kushtetutës, Kapitulli XII, Neni 140, duhet të jetë një institucion i pavarur. Me të vërtetë, emërimi i Bedri Hamzës, nuk mund të thuhet se është emërim jopolitik. Neni 40 i Ligjit 03L-209, pika 3 e tij , specifikon që asnjë person nuk do të shërbejë, në organet vendimmarrëse, të Bankës Qendrore ,përderisa është antar i Kuvendit të Kosoves, Qeverisë, zyrtar i ndonjë Ministrie ose ndonjë entiteti tjetër publik . Kjo, do të thotë se, kemi të bëjmë me shkelje të ligjit dhe procedurave dhe theksoi se vota e saj është kundër këtij emërimi.

Latif Gashi mendoj se Hykmete Bajrami bëri një interpretim të gabuar të ligjit kur u shpreh, se , asnjë person i qeverisë nuk mund të emërohet për guvernator të Bankës Qëndrore. Bedri Hamza nuk është më zyrtar i Qeverisë, ka dhënë dorëheqje dhe tani është një qytetar, të cilit nuk i mohohet e drejta të aplikojë për çfarëdo pozite.

Albana Fetoshi mendoj , se ,Banka Qëndrore, nuk duhet që të politizohet dhe nuk po më duket aspak e logjikshme kjo.Një ish ministër, i cili qëndroi shumë shkurt në këtë post, tani dha dorëheqje, për ta marrë postin e Guvernatorit të Bankës Qëndrore. Po ashtu, nuk mund të thuhet që është komplet person jopolitik, sepse dihet arsyeja pse dha dorëheqje ,pra ,dha dorëheqje që ta merr postin e Guvernatorit të

Bankës, kështu që, nuk pajtohem aspak me konstatimin e Latif Gashit, që tha ai, kur thotë se ka dhënë dorëheqje dhe më nuk është person politik. Pikërisht, emërimi i Bedri Hamzes është një tendencë që të kontrollohet ky Institucion.

Latif Gashi në këtë rast, nuk ka shkelje të ligjit. Çdo qytetar i Republikës së Kosovës, në një farë mënyre është i politizuar dhe nëse, Bedri Hamza e merr pozitën, pra votën e deputetëve, është i detyruar të jap dorëheqje nga çdo funksion ,edhe pse tani nuk ushtron asnjë funksion.

Naser Osmani është fjala për dy kolegë tonë, që faktikisht kanë qenë shumë të ndërlidhur me komisionin tonë,dhe që të dy kanë kualitete. Vlerësime politike duhet të japin shefat e grupeve parlamentare, kur do t'i diskutojnë këto para seancës dhe atje do të shihet se a do të përkrahen apo nuk do të përkrahen, prandaj për shkak të bashkëpunimit korrekt që kemi pasë, nuk do të doja ta shtrijmë këtë diskutim, në këtë mënyrë. Tek ne kanë ardhur vetëm propozimet dhe këto rekomandime ne i përcjellim në seancë , ndërsa është Kuvendi ai që vendos .

Hykmete Bajrami shefi i grupit parlamentar të LDK-së ka treguar se kur vjen propozimi për Guvernatori e Bankës Qëndrore të Kosovës do ta lëshojnë seancën dhe se ajo qfarë thash unë është konsistente me qëndrimet e partisë.

Kryetarja secili grup parlamentar do ta merr qëndrimin se si do të veprojë, në seancën parlamentare dhe subjektet politike mund të mos rrinë në seancë, është e drejtë e tyre. Ne i kemi dy kandidatë dhe dy bashkëpunëtorë të Komisionit dhe në seancën plenare njërin prej tyre duhet me votu. Të dy janë njohës të mirë të fushës për të cilën kanë konkurrar, prandaj ti lëmë anash politizimet dhe të marrim vendim në bazë të dokumentacionit që e kemi prezent.

Xhevdet Neziraj nuk kam marrë qëndrim të partisë të cilën e përfaqësoj, mirëpo për shkaqe parimore, mendoj se janë dy kandidatë që kanë një kredibilitet dhe janë profesionistë të mirë që e njohin lëmin dhe nuk mund të votojmë kundër, ngase dy kandidatët i plotësojnë kriteret profesionale, prandaj, për këtë vendos Kuvendi.

Sali Asllanaj qëndrimin që prezntoi Hykmetja qëndron plotësisht; nuk mund të themi që sot dha dorëheqje dhe është person jopolitik . Se çfarë qëndrimi do të mbajnë grupet parlamentare, objektivisht do të mbetet të shihet , por edhe pse kam konsideratë për ish ministrin,nuk do të thotë që do ta votoj.

Naser Osmani ka keqkuptime dhe keqinterpretime, ne nuk përcaktohem për asnjëri , ne duhet këtë ta përcjellim në Kuvend dhe aty vendoset politikisht; a rrinë në sall apo jo, a votojnë apo jo.

Hykmete Bajrami ne po shprehim thjeshtë, mendimet tona ,dhe, nuk është poenta që këtu vetëm të vijnë personat e propozuar dhe komisioni t i përcjellë, ne votojmë këtu dhe duhet të sqarojmë pse votojmë për dhe pse votojmë kundër . Vërejtjet e mija, janë vetëm në politizim të institucioneve dhe jo në kualitetet e kandidatëve .

Pas diskutimeve , Komisioni me tetë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj), tri Kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë njërin prej kandidatëve për pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim:

Bedri Hamza,
Gani Gërguri.

2. Kandidati i përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohet Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-189 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë përgjithshme të produkteve, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për sigurinë përgjithshme të produkteve dhe amendmentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. **Shqyrtimi i amendamentit plotësues të Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin nr.04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit**

Kryetarja njoftoi se Komisioni ka shqyrtuar projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe amendamentet e komisionit funksional dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Mirëpo gjatë shqyrtimit të Raportit në Seancë plenare, janë bërë vërejtje dhe si rezultat projektligji iu është rikthyer për rishqyrtim komisionit funksional, i cili ka propozuar një amendament plotësues që nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Amendamenti plotësues i Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me Projektligjin nr.04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

6. **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit të Pavarur për Media për kompensimin e takimeve ditore**

Kryetarja siç keni mundur të shihni nga kërkesa, Komisioni i Pavarur për Media ka kërkuar nga Komisioni të lejojë kompensimin e takimeve ditore për anëtarët e KPM-së. Mendojë që keni të bëjmë me një kërkesë që nuk është e bazuar në ligj, pasi që në ligjin për KPM-në përveç nivelit të kompensimit mujor për kryesuesin dhe anëtarët tjerë që tashmë është përcaktuar nga Kuvendi, nuk parashihi

dispozita që parashohin kompensime tjera. Prandja ne si komisioni duhet të kthejm një përgjigje ku do të thuhet se niveli i kompensimit të kryesuesit dhe anëtarëve të KPM-së është përcaktuar nga Kuvendi dhe duhet të ekzekutohet në atë nivel për të gjitha aktivitetet e anëtarëve të KPM-së, deri në miratimin e Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë.

Sipas propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

1. Ligji nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media nuk parasheh ndonjë dispozitë që rregullon qështjen e komensimeve apo shtesave tjera, përveç nivelit të kompensimit për kryetarin dhe anëtarët e KPM-së që është paraparë të caktohen me Ligjin për Pagat e Zyrtarëve të Lartë (neni 45, paragrafi 4).
2. Në mungesë të Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë, Kuvendi i Kosovës me Vendim nr.04-V-494, të datës 13 dhjetor 2013, ka caktuar nivelin e kompensimit mujor për kryetarin dhe anëtarët e KPM-së, i cili është i vlefshëm deri në miratimin e Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, vlerëson se deri në miratimin e Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë, kryetari dhe anëtarët e KPM-së, për të gjitha aktivitetet e tyre, marrin kompensimin mujor në shumën e përcaktuar nga Kuvendi.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për shtesa në paga dhe kompensime për zyrtarët e ARH-së

Kryetarja kërkesa e ARH-së ka për qëllim të merret një leje nga komisioni për ekzekutimin e shtesave në paga dhe kompensime për zyrtarët e këtij autoriteti për qka edhe është bashkangjitur një listë me emra dhe janë propozuar shumat. Nëse iu referohemi Ligjit për Hekurudhat e Kosovës, anëtarët e Bordit të ARH-së marrin një kompensim fiks mujor për të gjitha aktivitetet e tyre, i cili përcaktohet sipas propozimit të bordit dhe miratimit nga Kuvendi. Kuvendi me vendim tashë ka caktuar nivelin e kompensimit fiks për anëtarët e bordit të ARH-së që është i vlefshëm deri në miratimin e ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publik. Sa i përket stafit të këtij autoriteti, ata gëzojnë statusin e shërbyesve civil, dhe qështje e pagave, shtesave dhe kompensimeve tjera duhet trajtohet sipas ligjeve për shërbimin civil, për të cilat përgjegjëse për zbatimin e tyre është ministria e administratës publike dhe ministria e financave.

Hykmete Bajrami theksoi se sa i përket kërkesës për stafin që kanë statusin e shërbyesve civil , ne do të duhej të rekomandojmë se ata duhet trajtuar sipas ligjeve për shërbimin civil dhe akteve nënligjore që derivojnë nga këto ligje.

Sipas propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

1. Ligji nr.04/L063 për Hekurudhat e Kosovës (neni 38, paragrafi 6, nënparagrafet 15 dhe 16), përcakton se çdo anëtar i Bordit të ARH-së merr një shumë fikse të kompensimit për përmbushjen e detyrave ligjore të tyre. Përcaktimi i shumës fikse të kompensimit propozohet nga bordi i ARH-së dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Në bazë të propozimit të Bordit, Kuvendi

me Vendim ka caktuar nivelin e kompensimet mujor për kryesuesin dhe anëtarët e Bordit të ARH-së, i cili është i vlefshëm deri në miratimin e Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë publik.

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, vlerëson se deri në miratimin e Ligjit për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik, kryetari dhe anëtarët e Bordit të ARH-së për të gjitha aktivitetet në përmbushjen e detyrave të tyre, marrin kompensimin mujor fiks në shumën e përcaktuar nga Kuvendi.
3. Punonjësit e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave që e kanë statusin e shërbyesve civil, duhet të trajtohen në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet nënligjore që janë nxjerrur bazuar në këto ligje. Pagat, shtesat dhe kompensimet e shërbyesve civil, rregullohen dhe përcaktohen në pajtim me këto akte ligjore dhe nënligjore, përfshirë Rregulloren Nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, për të cilën përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregullore është Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave.

Mbledhja përfundoi: 10:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj